



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLAKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHË D (I)
(Rusisht)

Ngarkesa: 4 ECTS, 40 orë seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: 2026- 2027 ,Viti I / Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me përzgjedhje/kategoria D

Programi i studimit: Program studimi profesional dyvjeçar "Komunikim Shumëgjuhësh në Insitucione dhe Ndërmarrje ".

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 5, 6, 7,)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Lënda “**Gjuhë C (I)** ” bën pjesë në disiplinat gjuhësore praktike të formimit të përgjithshëm në mësimin e gjuhës së huaj. Ajo studiohet në vitin e parë, cikli i I i studimeve, semestri I, 40 orë mësimore, përkatësisht 3 orë/javë në programin mësimor. Qëllimi kryesor i kursit është të zhvillojë aftësitë themelore gjuhësore të studentëve në rusisht, duke i mundësuar ata të kuptojnë dhe përdorin gjuhën ruse në situata të përditshme. Kursi synon që studentët të jenë në gjendje të:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Të komunikojnë në situata të përditshme në rusisht.
- Të përdorin strukturat gramatikore dhe fjalorin bazë.
- Të kuptojnë mesazhe dhe tekste të thjeshta të shkruara dhe të dëgjuara.
- Të shkruajnë fjali dhe mesazhe të thjeshta.
- Të përdorin gjuhën ruse në mënyrë të pavarur në situata të zakonshme.

Objektivat specifike lëndore:

Pas kursit studentët do të jenë në gjendje të:

- Komunikojnë në situata të përditshme dhe të prezantohen.
- Lexojnë dhe kuptojnë tekste të shkurtra dhe njoftime bazë.
- Shkruajnë fjali dhe mesazhe të thjeshta.
- Përdorin strukturat gramatikore dhe fjalorin bazë të nivelit A1.
- Shprehin ndjenja, përshkruajnë ambientin dhe situata të zakonshme sociale



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHE E HUAJ D-1 TURQISHT

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore, 40 seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti 1, semestri 1

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Program studimi profesional dyvjeçar "Komunikim Shumëgjuhësh në Institucione dhe Ndërmarrje"

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

Objektivat e përgjithshme lëndore: Studenti duhet të ketë njohuri themelore në gjuhën turke. Lënda gjuhë turke si gjuhë e dytë zhvillohet në dy module të vendosura në semestrin e parë dhe semestrin e dytë. Studentët do të punojnë me metodën e nivelit të avancuar, në nivelin A1- A 2 të metodës së përzgjedhur për mësim. Do dinë të përdorin aftësitë e të lexuarit kritik në gjuhën e huaj si leximi për të marrë kuptimin, për të nxjerrë konkluzione. Do përdorin strategji komunikimi.

Objektivat specifike lëndore: Shkrimi i prezantimeve, organizim i mësimit në gjuhën turke.

Puna me fjalor të avancuar duke përdorur hamendësimin, nxjerrjen e kuptimit nga konteksti, njohjen e parashtesave dhe prapashtesave. Zgjerimin e fjalorit duke përdorur përkufizimin, përdorimin e fjalëve në fjali.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHË E HUAJ (GREKE)
(MODULI I)

Ngarkesa: 6 ECTS | 60 orë mësimore (20 leksione + 40 seminare)(Moduli 1)

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti I, Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Programi i Studimit Profesional Dyvjeçar në “Komunikim shumëgjuhësh në Institucione dhe Ndërmarrje”

Kodi i etikës: Kodin e Etikës së UT-së, (Nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS:

Ky modul synon zhvillimin e kompetencave gjuhësore të studentëve në gjuhën greke, të orientuara drejt konteksteve administrative dhe institucionale. Në fokus janë format e komunikimit shumëgjuhësh profesional, strukturat gjuhësore dhe terminologjia e nevojshme për të vepruar në situata pune në institucione publike ose ndërmarrje private ku kërkohet përdorimi i greqishtes. Përmes temave funksionale, studentët përvetësojnë mënyra të sakta të prezantimit, korrespondencës zyrtare, pjesëmarrjes në mbledhje, komunikimit shumëgjuhësh me qytetarë apo eprorë, si dhe të sjelljes profesionale në mjedise shumëgjuhëshe.

Programi bazohet në materiale autentike të përgatitura nga Qendra për Gjuhën Greke dhe tekste bashkëkohore që reflektojnë situata reale të mjedisit të punës, duke synuar përgatitjen e studentëve për përdorimin praktik të gjuhës në funksione të ndryshme të administratës dhe sektorit të shërbimeve.

Rezultatet e të nxënës:

Në përfundim të kësaj lënde, studenti do të jetë i aftë të:

1. Përdorë greqishten standarde në situata profesionale të zakonshme në administratë dhe ndërmarrje;
2. Prezantojë veten dhe të tjerët në mënyrë të përshtatshme në kontekste formale dhe institucionale;
3. Kuptojë dhe të hartojë tekste të thjeshta zyrtare si njoftime, kërkesa, emaile apo dokumente bazë administrative;
4. Zbatojë normat gjuhësore dhe të sjelljes në ndërveprime të përditshme me kolegë, qytetarë dhe drejtues në një mjedis institucional greqishtfolës;
5. Ndërveprojë në mënyrë efikase në takime dhe situata funksionale duke përdorur shprehjet e nevojshme për komunikim të qartë, të saktë dhe të respektueshëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
KULTURA DHE QYTETËRIME EVROPIANE

Ngarkesa: 3 ECTS | 10 orë leksion | 20 orë seminar

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Program studimi profesional dy-vjeçar në Komunikim shumëgjuhësh në Institucione dhe Ndërmarrje

Kodi i etikës: Kodin e Etikës së UT-së, (Nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE E LËNDËS:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të zhvillojë te studentët një kuptim të përgjithshëm mbi zhvillimin historik, kulturor dhe shoqëror të qytetërimeve evropiane dhe mbi proceset që kanë formësuar identitetin evropian. Të aftësojë studentët të kuptojnë dhe interpretojnë rolin e kulturës, fesë, filozofisë, artit dhe traditave në zhvillimin e shoqërive evropiane. Të zhvillojë aftësinë e studentëve për të analizuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike proceset historike, kulturore dhe shoqërore që kanë ndikuar në formimin dhe integrimin e Evropës. Të nxisë te studentët ndërgjegjësimin për diversitetin kulturor, gjuhësor dhe ndërkulturor të Evropës, si dhe respektin ndaj vlerave dhe identiteteve të ndryshme evropian

Objektivat specifike lëndore :

- Të fitojë njohuri mbi periudhat dhe ngjarjet kryesore të zhvillimit të qytetërimeve evropiane, nga trashëgimia antike deri në Evropën bashkëkohore.
- Të identifikojë dhe të shpjegojë ndikimin e kulturës, fesë, filozofisë, letërsisë, artit dhe traditave në formimin e shoqërive dhe identitetit evropian.
- Të kuptojë dhe të analizojë proceset e modernizimit, krijimit të shteteve kombëtare dhe integritetit evropian.
- Të zhvillojë aftësi për të analizuar dhe interpretuar burime të thjeshta historike, kulturore, letrare dhe materiale vizuale.
- Të zhvillojë aftësi për të krahasuar kultura, tradita dhe zhvillime shoqërore të vendeve të ndryshme evropiane, duke evidentuar ngjashmëritë dhe dallimet.

Rezultatet e të nxënit:

Pas përfundimit të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje të:

1. Përshkruajë periudhat kryesore të zhvillimit të qytetërimeve evropiane.
2. Shpjegojë rolin e kulturës, fesë, filozofisë dhe artit në formimin e Evropës.
3. Kuptojë proceset historike që kanë ndikuar në bashkëpunimin dhe integrimin evropian.
4. Analizojë burimet e thjeshta historike dhe kulturore.
5. Diskutojë dhe krahasojë shembuj nga vendet e ndryshme të Evropës.
6. Të zhvillojë aftësi për të kuptuar dhe respektuar diversitetin kulturor evropian.